



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

---

Numri i lëndës: 2020:033077

Datë: 28.05.2021

Numri i dokumentit: 01827554

**P.nr.95/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Nexhat Aliu, me Sek. Juridike, Azize Rama, në qështjen penale të akuzuarit NN nga fsh.NN K.Vitise, i akuzuar për shkak të veprës penale, vjedhja e sherbimve nga neni 314 parag.1,të KPRK-së, e sipas aktakuzës PP.II. nr.306/2020 të dates 28.02.2020, dhe pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datën 12.05.2021, shpall këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari** NN nga babai NN, dhe nëna NN i vajzëris NN , i lindur 13.09.1942 në fsh.NN K.Viti, ku dhe jeton, me nr.personal 1012566715, ka të kryer shkollen fillore 4 vjeqare,pezionist i pleqëris, me gjendje të dobët ekonomike, i martuar, baba i 7 femive, deri me tani kinse i pa denuar, shqiptar , shtetase i Republikës së Kosoves,

### **ËSHTË FAJTORË SEPSE**

Prej dates se pavartetuar e deri me daten 06.07.2019, ne kohë të papërcaktuar, në fsh.NN të Komunës së Vitisë, në pronën të cilën e shfrytëzonte, në mënyrë të kunderligjshme ka siguruar shërbime të KEDS-it Distrikti në Gjilan, për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe ka shmangu pagesën për shërbime të tilla në atë mënyrë që pas shkyqjes në njëhisorin elektrik me komandë nga distance është lidhur direkt jashte pikës matëse në rrjet të shpërdarjes së rrymës dhe pa autorizim ka shpenzuar energji elektrike pa u regjistruar ajo askund si shpenzim, me q ‘ rast KEDS-in Distriktin në Gjilan, e ka dëmtuar për shumën e të hollave në vlerë prej 63.20Euro.

-me qka ka kryer vepër penale vjedhja e sherbimve nga neni 314 parag.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenëve 38,39,47,48 dhe neni 69 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së.

## E G J Y K O N

Me dënim burgu në kohzgjatje prej **60 (gjashtdhjet) ditë**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, ME KUSHT që në afat prej 12 muajsh, mos të kryej vepër tjetër penale.

**Obligohet** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **10,00 € (dhjetëeuro)**, kurse në emër të paushallit gjyqsor sumën prej **10,00 € (dhjetëeuro)**.

E dëmtuara KEDS-distrikti në Gjiilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

## A r s y e t i m

PSh-re, nga Gjilani, me dt.28.02.2020, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.306/2020, kundër të akuzuarit NN, nga fsh. NN, K.Viti, për shkak të veprës penale, vjedhja e shërbimve nga neni 314 parag. 1, të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtorë, dhe ta dënoj me dënim meritor sipas ligjit.

I akuzuari NN, ka pranuar fajsin për veprën penale e cila i vihet në barrë si në aktin akuzues. Edhe pse ka qenë i njoftuar me pasojat dhe favore të pranimit të fajsisë.

PSh-re nga Gjilani, Halim Borovci në fjalën përfundimtare të palve ka deklaruar :Prokuroria Themelore në Gjilani ka ngritur aktakuzat ndaj të akuzuarit NN ka praqitur provat personale dhe materiale provat të mjaftueshme dhe qëndron prapa saj me qenë në këtë fazë është bërë pranimi i fajsisë edhe për kundërshtar se është njoftuar me pasojat dhe benifitit të pranimit të fajsisë nga i akuzuari, andaj i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, me rastin e caktimit të llojit të dënimit të mirren të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe të njëjtin ti caktohet denimi proporcional me peshën e veprës penale, dhe demin e shkaktuar të dëmtues.

I akuzuar NN në fjalën përfundimtare të palve ka kërkuar nga gjykata që t' i shqipton një dënim më të butë, nga se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale , i ka premtuar gjykatës që në të ardhme nuk do të kryer vepra tjera penale të këtij lloji apo të llojit tjetër. E ka njoftuar gjykatën se është me gjendje të dobët ekonomike dhe është shfrytëzues i ndihmave sociale.

Gjykata analizoi mbrojtjen e të akuzuarit, provat e adminstruara dhe erdhi në përfundim se i akuzuari NN, nga fsh. NN, ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimve nga neni 314 parag.1, të KPRK- së, që u vërtetua nga pranimi i fajsisë nga ana e vetë të akuzuarit për këtë vepër penale.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka pasë parasysh pranimin e fajsisë pa asnjë hezitim, është penduar thëllë për kryerjen e kësaj vepre penal, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepre penale ,më pare nuk ka qenë i dënuar dhe se për gjykatën nuk është i njohur

si kryes e veprave penale të këtij lloji apo të ndonji lloji tjetër. Me gjendje të dobët ekonomike dhe financiare.

Ndërsa rrethana rëndues përgjegjsin penale, rrezikshmëria shoqërore, pasojat e shkaktuara të dëmtuares me këtë vepër penale.

Për këtë arsye i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se edhe ky dënim do të ndikoi pozitivisht tek i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, ndërsa vendimi mbi kërkesën pasurore juridike konform nenit 458, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**  
**P. nr.95/2020**  
**Me.12.05.2021**

Sekretare Juridike,  
**Azize Rama**

Gj y q t a r i,  
**Nexhat Aliu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë në afatë prej 15 ditësh, nga dita e pranim, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.